



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 622/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga : Kimete Gashi - Kryetar, Agon Ramadani- Anëtar dhe Vedat Poterqoi- Antar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (OE) "Harst Group" sh.p.k, me seli në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore", me nr. të prokurimit: 616-22-4320-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, me datën 21.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Hedhet si e palejuar**, operatorit ekonomik, "Harst Group" sh.p.k, me seli në Suharekë e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit (me numër protokolli 622/2022) sepse ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj se është pale me interes siç parashihet me paragrafin 1 pika 26 të nenit 4 lidhur me nenin 111 të LPP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore", me nr. të prokurimit: 616-22-4320-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë.
- II. Lejohet**, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Prishtinë që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore", me nr. të prokurimit: 616-22-4320-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 21.10.2022, Kuvendi Komunal Prishtinë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-22-4320-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, ku është rekomanduar për kontratë OE N.P.N “Euro Construction”, Suharekë.

Me datë 25.10.2022, Operatori Ekonomik “Harst Group” sh.p.k, me seli në Suharekë, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK- Kuvendi Komunal Prishtinë, me datë 26.10.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues “Harst Group” sh.p.k, dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e datës 21.10.2022 të Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Prishtinë.

Me datën 07.11.2022 Operatori ekonomik “Harst Group” sh.p.k, me seli në Suharekë, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 622/2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë kornizë, vlera e parashikuar e kontratës: Lot 3, 100 000,00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta

bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 21.11.2022 eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e Operatorit Ekonomik ankues “Harst Group” sh.p.k, me seli në Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar,

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftuara për të vendosur në mënyrë meritore lidhur me këtë ankesë:

Marr parasysh faktin se OE ankues në ankesën e tij ka parashtruar pretendime me të cilat nuk ka atakuar edhe Operatorët Ekonomik tjerë ofertues në këtë aktivitet të prokurimit të cilët me vendimin e AK –së janë cilësuar si të pasukseshëm mirëpo të njëjtit janë më të lirë me ofertat e tyre se sa OE Ankues, paneli shqyrtues konstaton se në pajtim me paragrafin 1 pika 26 te nenit 4 lidhur me nenin 111 të LPP-së, ky OE kualifikohet si palë pa interes juridiko material në aktivitetin prokurimit në fjalë andaj edhe ankesa e tij hedhet si e pa lejuar duke u bazuar në paragrafin 1 pika 26 te nenit 4 lidhur me nenin 111 të LPP-së

- Përfundim -

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe paragrafin 1 pika 26 te nenit 4 lidhur me nenin 111 Ligjit të cituar dhe ankesën e parashtruar nga “Harst Group” sh.p.k, me seli në Suharekë e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit (me numër protokolli 622/2022), kundër njoftimit për dhënie te kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-22-4320-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë e hodhi si te pa lejuara në përputhshmëri me dispozitën e cekur si më lart.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Kimete GASHI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi Komunal Prishtinë

1x1 OE "Harst Group" sh.p.k, me seli në Suharekë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.